

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikalastic®-560

MEMBRANË E LËNGSHME EKONOMIKE PËR HIDROIZOLIMIN E TARRACAVE-ÇATIVE BAZUAR NË TEKNOLOGJINË SIKA CO-ELASTIC TECHNOLOGY (CET)



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikalastic®-560 është membranë e lëngshme hidroizolimi me 1 përbërës që aplikohet me metodën e ftohtë, me elasticitet të lartë dhe rezistencë ndaj rrezeve UV.

PËRDORIMET

- Për hidroizolim tarracash në projekte punimesh të reja dhe rikonstruksione
- Për tarraca me shumë detaje dhe gjeometri komplekse me akses të kufizuar
- Për zgjatje efikase të ciklit të jetës së tarracave të dëmtuara
- Shtresë përfundimtare me reflektivitet të lartë për përmirësimin e efikasitetit energjetik duke reduktuar koston e ftohjes

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 përbërës - gati për përdorim
- Aplikim me metodën e ftohtë - nuk kërkon nxehësi apo zjarr
- Membranë hidroizolimi pa bashkime
- Rezistencë dhe qëndrueshmëri ndaj rrezatimit UV
- Shumë elastik me mundësi ngushtimi të plasaritjeve
- Riveshje e lehtë kur nevojitet - nuk kërkohet të hiqet membrana e vjeter
- Ekonomik - ofron zgjatje të ciklit të jetës së tarracave/çative të dëmtuara me kosto efikase
- Veshje me bazë uji dhe çlirim të ulët VOC
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi nënshtresa poroze dhe joporoze
- I përshkueshëm nga avujt e ujit - lejon transpirimin e nënshtresës
- 12 muaj jetëgjatësi

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtohet me LEED v2009 IEQc 4.2: Materiale me çlirime të ulëta - Bojëra & Veshje
- Pajtohet me LEED v2009 SSc 7.2 (Option 1): Heat Island Effect - Roof

MIRATIME / STANDARDE

- Membranë e lëngshme hidroizolimi tarracash sipas ETAG 005, ETA-12/0308 lëshuar nga organi i vlerësimit teknik Instituto de ciencias de la construction Eduardo Torroja, Deklaratë Performance 99240033, mbart markën CE
- Plotëson kërkesat e reflektivitetit fillestar diellor sipas Energy Star (0.820)
- Plotëson kërkesat e performancës ndaj zjarrit të jashtëm ENV 1187 B_{Roof} (T1) mbi nënshtresa jo të djegshme

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Dispresion akrilik i modifikuar me poliuretan	
Ambalazhi	kovë plastike 20 kg kovë metalike 20 kg	
Ngjyra	Gri, terracotta, e kuqe dhe e bardhë (Energy Star)	
Jetëgjatësia	Kova plastike: 18 muaj nga data e prodhimit Kova metalike: 12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Temperaturat më të larta të magazinimit mund të reduktojnë jetëgjatësinë e produktit. Referohuni gjithashtu tek rekomandimet e dhëna në fletën e të dhënave të sigurisë.	
Dendësia	~1.35 kg/l (+23 °C)	(EN ISO 2811-1)
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~65 % (+23 °C / 50 % lagështi relative)	
Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim	~48 % (+23 °C / 50 % lagështi relative)	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	Pa përforsim	~1.5 N/mm ²	(DIN 53504)
	Përforsim me Sikalastic® Fleece-120	~12 N/mm ²	
	Përforsim me Sikalastic® Reemat Premium	~4–5 N/mm ²	
Zgjatimi deri në thyerje	Pa përforsim	~350 %	(DIN 53504)
	Përforsim me Sikalastic® Fleece-120	~40–60 %	
	Përforsim me Sikalastic® Reemat Premium	~70–80 %	
Reflektimi i rrezatimit diellor	0.82 ¹⁾		(ASTM C 1549)
	¹⁾ Të gjitha vlerat referohen në gjendjen fillestare (tharje e duhur, pa ndikime nga kushtet e motit) të Sikalastic®-560 ngjyrë e bardhë.		
Emetimi termik	0.93 ¹⁾		ASTM E 408
	¹⁾ Të gjitha vlerat referohen në gjendjen fillestare (tharje e duhur, pa ndikime nga kushtet e motit) të Sikalastic®-560 ngjyrë e bardhë.		
Treguesi i reflektimit të rrezatimit diellor	102 ¹⁾		(ASTM E 1980)
	¹⁾ Të gjitha vlerat referohen në gjendjen fillestare (tharje e duhur, pa ndikime nga kushtet e motit) të Sikalastic®-560 ngjyrë e bardhë.		
Temperatura e funksionimit	Me përforsim	Pa përforsim	
	-10 °C min. / +80 °C max.	-5 °C min. / +80 °C max.	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Veshje për çati/tarraca*

Sikalastic®-560 aplikohet në 2 ose 3 veshje

Konsumimi i plotë $\geq 0.9 - 1.4 \text{ kg/m}^2 (\geq 0.6 - 1.0 \text{ l/m}^2)$

Trashësia e cipës së thatë $\geq 0.3 - 0.5 \text{ mm}$

*Për përforsim të pjesshëm aplikohet Sikalastic® Fleece-120 ose Sikalastic® Flexitape Heavy në zona me lëvizshmëri të lartë, nënshtrësë të çrregullt ose për të ngushtuar plasaritje, fuga dhe bashkime mbi nënshtrësë si dhe gjithashtu për detajet. Mbi letrat e katramasë duhet të aplikohet një sistem i plotë hidroizolimi i përforsuar.

Për prajmerin, ju lutemi referohuni në tabelën e mëposhtme të trajtimit paraprak të nënshtrësës.

Hidroizolim i përforsuar çatie/tarrace

Sikalastic®-560 aplikohet në 1 veshje, përforskohet me Sikalastic® Fleece-120 ose Sika® Reemat Premium dhe izolohet me 1-2 veshje Sikalastic®-560

Shtresa	Produkti	Konsumimi
1. Prajmer	ju lutemi referohuni në trajtimin paraprak të sipërfaqes	ju lutemi referohuni në trajtimin paraprak të sipërfaqes
2. Veshja fillestare	Sikalastic®-560	$\geq 1.0 - 1.5 \text{ kg/m}^2 (\geq 0.75 - 1.1 \text{ l/m}^2)$
3. Përforsimi	Sikalastic® Fleece-120 ose Sika® Reemat Premium	-
4. Veshja përfundimtare	Sikalastic®-560 aplikuar në 1-2 veshje	$\geq 1.1 - 1.3 \text{ kg/m}^2 (\geq 0.8 - 0.95 \text{ l/m}^2)$

Shënim: Mos aplikoni më shumë se 0.75 kg/m^2 Sikalastic®-560 / veshje për shtresat pa përforsim.

Shënim: Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel dhe firon.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit $+8 \text{ °C min.} / +35 \text{ °C max.}$

Lagështia relative e ajrit max. 80 % lagështi relative

Temperatura e nënshtrësës $+8 \text{ °C min.} / +35 \text{ °C max.}$
 $\geq 3 \text{ °C}$ mbi pikën e vesës

Lagështia e përmbajtur e nënshtrësës $\leq 6 \%$ pjesë për peshë
Pa lagështi rritëse sipas ASTM (fletë polietileni).

Përgatitja e nënshtresës

Nënshtresa	Prajmer	Konsumimi (kg/m²)
Nënshtresë me bazë çimentoje	Sikalastic®-560 holluar me 10 % ujë.	~0.3
Tulla dhe gurë	Sikalastic®-560 holluar me 10 % ujë.	~0.3
Pllaka qeramike (pa glazurë)	Sikalastic®-560 holluar me 10 % ujë.	~0.3
Membranë bituminoze	Kërkohet vetëm për aplikime me reflektivitet të lartë (Sikalastic® Metal Primer)* Përdorni vetëm sistem me përforcim të plotë	~0.2
Veshje bituminoze	Kërkohet vetëm për aplikime me reflektivitet të lartë (Sikalastic® Metal Primer)* Përdorni vetëm sistem me përforcim të plotë	~0.2
Metale	Sikalastic® Metal Primer	~0.2
Nënshtresa druri	Nënshtresat prej druri kërkojnë një shtresë të plotë Sikalastic® Carrier. Për parrmakë dekorativë të ekspozuar druri përdorni Sikalastic®-560 holluar me 10 % ujë.	~0.3
Bojëra	Subjekt i testeve për kompatibilitet dhe ndërkapje	

* Sikalastic® Metal Primer parandalon migrimin e fluororëve (volatilëve) bituminozë dhe përmirëson reflektivitetin afatgjatë.

Shënim: Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel dhe firon.

Për kohën e pritjes / mbiveshjen, ju lutemi referohuni në skedën teknike të pastruesit dhe prajmerit përkatës. Nënshtresat e tjera duhet të testohen për kompatibilitetin e tyre. Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

Koha e pritjes / mbiveshja	Koha e pritjes me Sikalastic® Fleece	Koha e pritjes pa Sikalastic® Fleece	Kushtet e ambientit
	24 orë	6 orë	+20°C/50% lagështi relative
	12 orë	4 orë	+30°C/50% lagështi relative

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

Produkti i aplikuar gati për përdorim	I thatë në prekje	Rezistent ndaj shiut	Tharja e plotë	Kushtet e ambientit
	~2 orë	~8 orë	~4 ditë	+20°C/50% lagështi relative
	~1 orë	~4 orë	~2 ditë	+30°C/50% lagështi relative

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme, me rezistencë të mjaftueshme, e pastër, e thatë dhe pa pislleqe, vaj, graso dhe kontaminues të tjerë. Në varësi të materialit, nënshtresa duhet të lyhet me prajmer ose të përgatitet mekanikisht. Mund të nevojitet bluarje për nivelimin e sipërfaqes.

Nënshtresa të përshtatshme janë: betoni, membranat dhe veshjet bituminoze, metalet, tullat, çimento me gëlqere, pllaka qeramike, nënshtresa druri.

Për informacione të detajuara rreth përgatitjes së nënshtresës dhe tabelës së prajmerit ju lutemi referohuni tek Method Statement Nr. 850 94 03.

PËRZIERJA

Përpara aplikimit, përzieni plotësisht Sikalastic®-560 për 1 minutë për të përfutur një miks homogjen. Duhet të shmanget përzierja e tepruar për të minimizuar bllokimin e ajrit.

APLIKIMI

Përpara aplikimit të Sikalastic®-560 veshja e prajmerit (nëse përdoret) duhet të jetë tharë e të mos jetë e ngjithshme. Për kohën e pritjes / mbiveshjen ju lutemi referohuni në skedën teknike të prajmerit të duhur. Zonat e dëmtueshme (kasa dyersh) duhet të mbrohen me shirit adeziv.

Veshje për çati/tarraca: Sikalastic®-560 aplikohet në 2 ose 3 veshje. Përpara aplikimit të veshjes së 2-të duhet të lini kohën e pritjes që tregohet në tabelën më sipër.

Hidroizolim çatie/tarrace: Sikalastic®-560 aplikohet në kombinim me Sikalastic® Fleece 120 ose Sika® Reemat Premium.

1. Aplikoni veshjen e parë në ~ 0.75 kg/m² (për nënshtresa jo absorbuese) - 1.00 kg/m² (për nënshtresa absorbuese) Sikalastic®-560 mbi një gjatësi ~ 1m.
2. Vendosni përsipër Sikalastic® Fleece-120 ose Sika® Reemat Premium dhe sigurohuni se nuk ka flluska apo palosje. Mbivendosja e rretës duhet të jetë min. 5 cm.
3. Aplikoni veshjen e dytë ~ 0.25 kg/m² - 0.5kg/m² direkt mbi rretën e lagur për të arritur trashësinë e kërkuar të cipës. I gjithë aplikimi duhet të ndodhë ndërsa Sikalastic®-560 është ende i lëngët, i lagësht mbi të lagësht.
4. Përsërisni hapat 1-3 derisa zona e çatisë/tarracës është hidroizoluar.
5. Pasi të jenë tharë dy veshjet, izoloni zonën e çatisë/tarracës me një ose më tepër veshje shtesë Sikalastic®-560 (≥ 0.5 kg/m² për veshje).

Ju lutemi kini parasysh se gjithmonë duhet të filloni me detajet përpara se të filloni me hidroizolimimin e sipërfaqes horizontale.

Për informacione të detajuara rreth metodës së aplikimit ju lutemi referohuni tek Method Statement Nr. 850 94 03.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos aplikoni Sikalastic®-560 mbi nënshtresa me lagështi në rritje.
- Sikalastic®-560 nuk është i përshtatshëm për zhytje të përhershme në ujë.
- Mbi nënshtresa ku ka gjasa degazimi (çlirimi gazesh), aplikoni gjatë rënies së temperaturës së ambientit dhe nënshtresës. Nëse aplikohet gjatë temperaturave në rritje, mund të shfaqen flluska nga përhapja e ajrit të bllokuar.
- Siguroni se temperatura e mjedisit nuk bie nën 8°C dhe se lagështia relative nuk kalon 80% deri në tharjen e plotë të membranës.
- Sikalastic®-560 nuk duhet të aplikohet mbi tarraca/çati subjekt i grumbullimit afatgjatë të ujit.
- Sikalastic®-560 nuk duhet të aplikohet mbi tarraca/çati subjekt i grumbullimit të ujit nëse do të vijojë periudhë ngricash. Në zonat me klimë të ftohtë me pjerrësi tarrace më pak se 3% duhet të merren masa të përshtatshme.
- Kur Sikalastic®-560 aplikohet mbi tarraca/çati subjekt i ngricës afatgjatë në temperaturë rreth temperaturës minimale të shërbimit prej -10°C, duhet gjithnjë të përforcohet me Sikalastic® Fleece-120 për të garantuar aftësinë e mbylljes së mjaftueshme të plasaritjeve.
- Mos aplikoni Sikalastic®-560 direkt mbi panele izolimi, por përdorni një shtresë ndarëse si Sikalastic® Carrier ndërmjet panelit të izolimit dhe Sikalastic®-560.
- Zonat me lëvizshmëri të lartë, nënshtresat e çrregullta apo çatitë/tarracat prej druri kërkojnë shtresë të plotë Sikalastic® Carrier.
- Sikalastic®-560 nuk rekomandohet për qarkullim këmbësorësh. Në rast se qarkullimi i këmbësorëve është i pashmangshëm, Sikalastic®-560 duhet të mbulohet me elementet e dhura si pllakat, pllaka guri ose panele druri.
- Mos aplikoni produkte çimentoje (p.sh. llaç pllakash) direkt mbi Sikalastic®-560. Përdorni një barrierë alkaline, p.sh. agregate të thata kuarci.
- Performanca e rezistencës ndaj zjarrit është testuar brenda kompanisë sipas ENV 1187 B_{Roof} (T1).

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / i lloji wb) është 140 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikalastic®-560 është < 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositetë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikalastic®-560
Shkurt 2019, Botimi 03.01
020915151000000004

Sikalastic-560-sq-AL-(02-2019)-3-1.pdf

